



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**

**14 Nr. 482/23**

**Dt. 23.06.2023**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “ Future BITS “sh.p.k. me seli në Prishtinë, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt. 16.06.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën 23.06.2023 bie këtë:

**V E N D I M**

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : “ Future BITS “sh.p.k. me seli në Prishtinë e datës 21.06.2023, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër vendimit mbi Njoftimin e Autoritetit Kontraktues të datës 16.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ Furnizimi dhe instalimi i monitorit LED “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: VU644 – 23 – 3917 – 1-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 037 – 121
2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së do të vazhdoi me ri vlerësim të aktivitetit të prokurimit.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka marrë vendim që , në aktivitetin e prokurimit : “ Furnizimi dhe instalimi i monitorit LED “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: VU644 – 23 – 3917 – 1-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 037 – 121 , të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik : “ Elektro Plus “sh.p.k. me seli në Vushtrri.

Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. “ Future BITS “sh.p.k. me seli në Prishtinë ( në tekstin e mëtejme Ankuesi ) e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimi të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar. Në dosjen e tenderuese të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës rezulton se mungon dorëzimi i Sigurimit të Tenderit, i kërkuar në Dosjen e Tenderit, pjesa FTD – nenin 13.1. Rrjedhimisht, mungesa e Sigurimit të Tenderit, tenderin e O.E. te rekomanduar për dhënie të kontratës e bënë të papërgjegjshëm. sepse kjo mangësi e konstauar, sikurse ka vlerësuar A.K. paraqeset devijim substancial nga kërkesat e dosjes së tenderit, mungesa e dokumentit në fjalë përbënë largim dhe kufizim thelbësorë nga Kërkesat e Dosjes së Tenderit për arsye se :

- Dallonë esencialisht nga kushtet dhe dhe specifikimet e dosjes së tenderit dhe
- Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat, dhe si të tilla këto mangësi e bëjnë tenderin e Ankuesit të papërgjegjshëm.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratë tek “ Përshkrimi i Çmimeve “ ka bërë llogaritje të gabuar të TVSH-së dhe se diferenca e përmirësuar paraqet gabim aritmetikorë që kalon 2% nga totali i çmimit të dhënë nga O.E. në ofertën e tij financiare, A.K. këtë pretendim e konsideron si të paqëndrueshëm. Megjithatë kjo çështje nëse konsiderohet e nevojshme për rishqyrtim mbetet të interpretohet gjatë procesit të rivlerësimit të tenderëve.

**Këshillë juridike:**


Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë  
K.R.. nr. 037/2023, datë 23.06.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

**Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik**



Alban Tahiraj